



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË LEZHE, QARKU LEZHE
TË PROPOZUAR NGA PARTIA KOMBËTARE KONSERVATORE ALBANIA PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 16.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Lezhë Z. Eduart Mark Ndocaj të propozuar nga "Partia Konservatore Kombëtare", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur propozuar nga "Partia Konservatore Kombëtare" si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:



Nr. 418 i Vendimit

Data 16.05.2019

Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Lezhë të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

Në bazë të nenit 67, pika 2 dhe nenit 72 dhe 165, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", "Partia Kombëtare Konservatore Albania" ka depozituar në KQZ Kërkesën për rregjistrimin e z. Eduart Ndocaj si kandidat për kryetar të bashkisë Lezhë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Lezhë, pasi Bashkia Lezhë, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

1. Kërkesë për regjistrimin e z. Eduart Ndocaj kandidat për kryetar të Bashkisë Lezhë;
2. Deklaratat e kandidatit i cili deklaron se gëzon të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për Kryetar në Bashkinë Lezhë, të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania" në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019;
3. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 13 prot., datë 13.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se z. Kujtim Gjuzi është deklaruar se përfaqëson subjektin "Partia Kombëtare Konservatore Albania", dhe i pavarur.
4. Vërtetim i Këshillit Bashkiak Lezhë, nr. 4751/1 prot., datë 13.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se z. Petrit Gjon Ndreu anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, i propozuar nga subjekti politik "Partia Kombëtare Konservatore Albania".
5. Kopje e letërnjoftimit të z. Eduart Ndocaj sipas së cilës rezulton se z. Eduart Ndocaj është me vendbanim në Bashkinë Lezhë ;
6. Jetëshkrimin;
7. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
8. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në zbatim ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për të kandidatit për kryetar bashkie. KQZ gjithashtu ka publikuar formularin e vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve z. Eduart Ndocaj nuk është në kushtet e nenit 2,



Nr. 418 i Vendimit

Data 16.05.2019

Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Lezhë të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.

të ligjit nr. 138/2015, për refuzimin e tij si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 16.05.2019, verifikoi dokumentacionin e kandidimit për kryetar z. Eduart Ndocaj në Bashkinë Lezhë, të depozituar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania” dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pikat 2, neni 165 nenin 72 dhe neni 73 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Lezhë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, z. Eduart Ndocaj të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 418 i Vendimit

Data 16.05.2019

Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Lezhë të propozuar nga Partia Kombëtare Konservatore Albania, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.